

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2018**

Shënim: Skema e vlerësimit të testit të provimit të maturës do të plotësohet pas kontrollimit të një numri të caktuar të testeve dhe do të publikohet në faqen e internetit të Qendrës së Provimeve

1. Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** për përgjigje të plotë dhe të saktë: *Tregtari i Venedikut, Ëndrra e një nate vere, Antoni e Kleopatra dhe Përralla dimërore*
2. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të plotë dhe të saktë: *Si të doni dhe Nata e dymbëdhjetë*
3. Është rrethuar numri 2: *Që të përfaqësohen dramat më të mira e të gjitha zhanreve – 1 pikë*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon P dhe përshkruan ose perifrizon fjalitë: Në vitet e mëvonshme Shekspiri ka shkruar tragjedi dhe të ashtuquajturat drama problemore. Tipin e parë të dramës këtu e përfaqësojnë *Romeo dhe Zhulieta...Romeo dhe Zhulieta* nuk është dramë problemore, por tragjedi./ Dramat problemore në këtë përzgjedhje janë prezantuar me *Troilon dhe Kresidën. (dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
5. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të plotë dhe të saktë: 1. *Për suksesin në punë vendimtare është dashuria;* 2. *Këshillat për karrierë të suksesshme;* 3. *Planifikimi i karrierës.*
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan ose perifrizon fjalitë: Puno çfarë të duash me çka mund të kënaqesh. Përqendroju që të jesh më i miri në atë që dëshiron ta bësh./ Puno atë që e do. *(dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
7. Nxënësi merr **1 pikë** përgjigje të plotë dhe të saktë:

| KONSTATIMI VENDIMTAR PËR SUKSES NË PUNË | PO | JO |
|--|-------------------------------------|-------------------------------------|
| koeficienti më i lartë i inteligjencës | PO | <input checked="" type="radio"/> JO |
| shkollat më të mira | PO | <input checked="" type="radio"/> JO |
| profesioni më popullarizues | PO | <input checked="" type="radio"/> JO |
| kënaqësia në punë | <input checked="" type="radio"/> PO | JO |
| talenti | PO | <input checked="" type="radio"/> JO |
| këmbëngulja | <input checked="" type="radio"/> PO | JO |

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

8. Është rrethuar numri 3: *Suksesi i biznesit vjen nga dashuria për atë që bëjmë – 1 pikë*
9. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Sofokliu*
B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *tragjedisë*
10. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Në letërsinë antike*
B) Është rrethuar numri 2: *Eskili dhe Aristofani - 1 pikë*
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Kreonit/ mbretit të tebanëve*
12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *vetëbesimi / liria e zgjedhjes / trimëria / dashuria ndaj vëllait... (dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Është mbyllur në varrezën prej gurit / Kreoni e kishte varrosur të gjallë në varrezë. (dhe përgjigje të tjera të ngjashme)*
14. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë nëse shkruan saktë pranë personazhit letrar titullin e veprës në të cilën paraqitet dhe gjininë letrare të cilës i përket vepra:
- | | (vepra) | (gjinia letrare) | |
|--------------|--------------------------|-------------------------|-----------------|
| Enkidui / | <i>Epi i Gilgameshit</i> | <i>gjinia epike</i> | (1 pikë) |
| Dr. Dhalla / | <i>Doktor Gjilpëra</i> | <i>prozë artistike</i> | (1 pikë) |
| Zeneli / | <i>Pas vdekjes</i> | <i>gjinia dramatike</i> | (1 pikë) |
15. A) Është rrethuar numri 2: *nëpër – 1 pikë*
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Fjalët ja, pikërisht, mbase janë pjesëza (ja-pjesëz dëftuese, pikërisht-përcaktuese dhe mbase dyshuese), kurse nëpër është parafjalë*
- Shënim:** Nëse nuk është rrethuar përgjigjja e saktë nën A, nuk pranohet përgjigjja nën B edhe nëse është e saktë.
16. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *duke punuar*
17. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Në iluminizëm*

18. Është rrethuar numri 2: *Ndihet vazhdimisht i huaj në mjedisin ku jeton* – **1 pikë**

19. Është rrethuar numri 1: *Absurdit dhe njeriut* – **1 pikë**

20. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë nëse shkruan saktë titullin e veprës dhe autorin e saj:

Rrethimi i Shkodrës, Marin Barleti (1 pikë)

Kënga e sprasme e Balës, Gavril Dara (i Riu) (1 pikë)

Ofelia, Artur Rembo (1 pikë)

21. Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë nëse shkruan saktë emrin e personazhit i cili i thotë vargjet dhe emrin e personazhit me të cilin kanë të bëjnë vargjet, përkatësisht kujt i drejtohen ato:

1. I thotë Adham-Uti, lidhen me Zenelin (1 pikë)

2. I thotë Vurkua, lidhen me Adham-Utin (1 pikë)

3. I thotë Zonja Lulushe, lidhen me Zenelin (1 pikë)

22. Gjithsej **2 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë nëse shkruan saktë format shprehjeve artistike:

Raskoljnikovi: me monolog të brendshëm / të folme të brendshme të heroit dhe me dialog (1 pikë)

Sonja: me dialog (1 pikë)

23. Nxënësi merr **1 pikë** për një dallim të thjeshtë, p.sh.: në bazë të veprimeve të saj dhe të folurit.

Për një përgjigje më të plotë dhe me stil duke dhënë edhe dëshmi nga teksti (p.sh.: duartrokitja e saj, fjalitë e ndërprera, përsëritja e disa fjalëve, britma...) merr **2 pikë**

24. Nxënësi merr **1 pikë** për një dallim të thjeshtë, p.sh.: në fillim ndien frikë dhe pastaj duke u menduar dhe i qetë, për një moment bërtet, herë-herë qeshet.

Për një përgjigje më të plotë dhe me stil duke dhënë edhe dëshmi nga teksti (p.sh.: para se ta kryente vrasjen ndiente frikë, pas vrasjes në një çast kërkon t'i afrohet Sonja dhe i rrëfëhet në mënyrë që t'i lehtësojë

vuajtjet e brendshme dhe shqetësimet dhe atëherë është i qetë dhe i menduar, në momentin tjetër bërtet dhe vrasja që e ka kryer e largon nga Sonja të cilës në një moment i thotë se janë plotësisht të ndryshëm dhe se nuk janë njëri për tjetrin ...) merr **2 pikë**

25. Nxënësi merr 1 pikë për një dallim të thjeshtë, p.sh.: tregon dashuri.

Për një përgjigje më të plotë dhe me stil duke dhënë edhe dëshmi nga teksti (p.sh. tregon dashuri, gjë që shihet nga kalimi i saj gjatë të folurit nga ju në ti, ose kur Raskoljnikovi frikësohet se Sonja do ta braktis atë, ajo ia shtrëngon dorën dhe ndihet mirë që ia ka pranuar atë që ka bërë...) merr **2 pikë**

26. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Në mënyrën urdhërore*

27. A) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të plotë dhe të saktë për foljen kem pasë:

norma letrare - kemi pasur

mënyra - dëftore

koha - e kryer

forma - veprore

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Prej një veture*

28. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të plotë dhe të saktë: *automobil, viadukt, luan*

29. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan fjalën e cila nuk i përket vargut të dhënë: *peni*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar përgjigjen e fjalës së përshkruar: *Edhe te fjala peni duhet të kemi rotacizëm ashtu sikurse edhe te fjalët e tjera të dhëna në vargun e fjalëve nën A.*

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Analiza e romanit të mohimit
Nga jeta në jetë-pse?!**

| | |
|-------------------------------------|---|
| <p>Kërkesa 1.</p> | <p>Nxënësi thekson se: - romani trajton tri tema kryesore: jetën, dashurinë dhe vdekjen (1 pikë) <i>- Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë</p> |
| <p>Kërkesa 2.</p> | <p>Nxënësi shkruan për: - subjektin e veprës (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Nxënësi përshkruan: - kryepersonazhin Gjon Zaverin (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 4 pikë</p> |
| <p>Kërkesa 3.</p> | <p>Nxënësi tregon për: - personazhet e tjerë (Afërditën, Polën, Zonjën P. Gjenci, Z.Nasi etj. dhe fatin e tyre (1 pikë) - konfliktin e kryepersonazhit që është më tepër konflikt filozofik, meditativ sesa konflikt aktiv, që kërkon zgjidhje të lumtur (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Nxënësi tregon për: - problemet që e mundojnë kryepersonazhin (1 pikë) - fejesën që i bëjnë prindërit me Afërditën (1 pikë) - sjelljen e personazhit kryesor që është vazhdimisht rreth të njëjtit problem të jetosh ose të mos jetosh dhe shpëtimin që gjen ai (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 7 pikë</p> |
| <p>Kërkesa 4.</p> | <p>Nxënësi thekson: - përcaktimin përfundimtar të kryepersonazhit dhe arsyen që e shtyn në këtë hap (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë</p> |

Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku | Saktësia gjuhësore | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|--|--|---|--|
| <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p>3 pikë</p> | <p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> | <p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p>1 pikë</p> | <p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellitimit ndan paragrafët)</p> <p>2 pikë</p> |
| <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> | <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të</p> | | |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | <p>fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> | | |
| <p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p>1 pikë</p> | <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk</p> | | <p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | shkruhet bashkëtingëllorja j) 1 pikë | | |
| | Gjithsej 2 pikë | | |

Skema për vlerësimin e esesë: Për teatrin nga këndvështrimi im

| | |
|-------------------|---|
| Kërkesa 1. | Nxënësi arsyeton qëndrimin e vet për rolin e teatrit në shoqërinë bashkëkohore. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 2. | Nxënësi shpreh mendimin e vet për pozitën e kulturës dhe pasurinë e ngjarjeve kulturore në mjedisin ku jeton. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Nxënësi jep argumente për mendimin e vet për pozitën e kulturës dhe pasurinë e ngjarjeve kulturore në mjedisin ku jeton. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 4 pikë |
| Kërkesa 3. | Nxënësi sqaron dallimin në mes të teatrit dhe formave të tjera të artit. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë |
| Kërkesa 4. | - Nxënësi shkruan për titullin e veprës dramatike të cilën do të dëshironte ta shohë si shfaqje teatrale. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> - Nxënësi sqaron arsyen përse do të dëshironte ta shikonte pikërisht atë vepër dramatike si shfaqje teatrale. (1 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 4 pikë |
| Kërkesa 5. | Nëse nxënësi jep më shumë se një argument lidhur me mendimin e vet për nevojën e teatrit. (2 pikë) <i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë.</i> |

Gjithsej 3 pikë

Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku | Saktësia gjuhësore | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|--|---|--|
| <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p>3 pikë</p> | <p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> | <p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p>1 pikë</p> | <p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p>2 pikë</p> |
| <p>origjinaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p>2 pikë</p> | <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/</p> | | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | <p>xh, e/ ë, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> | | |
| <p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p>1 pikë</p> | <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të</p> | | <p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p>1 pikë</p> |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | <p>fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p> | | |
|--|---|--|--|